



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

KOMUNIKATË PËR MEDIA

09 janar 2021  
Prishtinë

Oda e Mjekëve të Kosovës me shqetësim, indinjatë dhe zhgënjim ka pranuar lajmin e sulmit ndaj kolegut Dr. V.K., anesteziolog kujdestar në Mjekim Intenziv, të Klinikës Infektive, sulmohet në Repartin e kësaj Klinike, nga familjarët e pacientit, pas orës 13:30, të datës 08 janar, me këtë rast doktorit në fjalë, i shkaktohen lëndime të rënda trupore.

Pastaj, është sulmur motra e repartit (reparti E), nga e njëjta palë, ku gjatë kësaj kohe, anesteziologu përgjegjës për Mjekim Intenziv, në Klinikën Infektive ka qenë duke reanimuar pacientin.

Oda e Mjekëve të Kosovës shprehë indinjatën e thellë për joefikasitetin e sistemit gjyqësor dhe të ndjekjes penale, që të krijojë praktikë të tillë me të cilën do të bënин të qartë për secilin qytetar se sulmet fizike ndaj personave zyrtar, përfshirë këtu edhe mjekët, janë veprime kriminale për të cilat shqiptohen sanksionet më të rënda të mundshme të parapara me ligjin penal për secilën vepër veç e veç. Veprimet kriminale që përbëjnë sulm fizik ndaj mjekut në vendin e punës duhet kualifikuar si vepër penale e sanksionuar me Kodin Penal të Republikës së Kosovës. Kjo hedh fajsinë edhe mbi institucionet shëndetësore të cilat duhet të sigurojnë personelin e vet në vendin e vet të punës.

OMK-ja do të angazhohet maksimalisht për të sensibilizuar opinionin dhe institucionet publike të Republikës së Kosovës, për nevojën e trajtimit serioz lidhur me sigurinë e mjekëve në vendin e tyre të punës dhe mbrojtjes së dinjitetit profesional të mjekut në shoqëri.

Kryetari i OMK-së  
Dr. Pleurat Sejdii, Mr.sci

